



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

BURSA STUDIMI NË KINË

VITI AKADEMIK 2019-2020

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh në fushën e arsimit, Qeveria e Republikës Popullore e Kinës për vitin akademik 2019-2020 ofron 4 (katër) bursa të plota në universitetet publike të Kinës, konkretisht:

- 2 (dy) bursë për studime universitare ose pasuniversitare në një fushë të caktuar interesi;
- 2 (dy) bursa për studime universitare ose pasuniversitare për shkenca mjekësore, në kuadër të Programit për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (CEEC).

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë nëpërmjet postës në adresë të Drejtorisë së Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dokumentet sipas kërkesës së palës kineze në informacionin bashkëlidhur dhe dokumentet sipas listës në vijim:

1. Kërkesën për studime universitare, duke specifikuar degën në të cilën kandidati dëshiron të studiojë. Kërkesa të jetë nënshkruar nga kandidati dhe të përmbajë adresë e-mail dhe numër kontakti;
2. Aplikantët që janë në ndjekje të gjimnazit duhet të dorëzojnë vërtetimin e notave për dy vitet e para të shkollës së mesme. Ky vërtetim duhet të jetë i firmosur nga Drejtoria Rajonale ose Zyra Arsimore e rrethit përkatës dhe nga Qendra e Shërbimeve Arsimore. Aplikantët që kanë përfunduar gjimnazin duhet të dorëzojnë diplomën e Maturës Shtetërore dhe vërtetimin e notave për tri vitet e shkollës së mesme. Ky vërtetim duhet të jetë i firmosur nga Drejtoria Rajonale ose Zyra Arsimore e rrethit përkatës dhe nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.
3. Një CV që përmban informacion për ciklet e shkollimit dhe adresat e shkollave ku kandidati ka studiuar;
4. Certifikata të ndryshme (fotokopje) për pjesëmarrje në konkurse ose olimpiada në nivel kombëtar ose ndërkombëtar;
5. Fotokopjen e pasaportës me të dhënat e identitetit;
6. 4 fotografi

Sqarojmë, se me postë duhet të dërgohen vetëm kopjet e noterizuara të dokumentacionit të kërkuar.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit do të jetë data **25 Mars 2019**.

Bursa mbulon shpenzimet e ushqimit, të akomodimit, tarifën e shkollimit dhe siguracionin shëndetësor. Ndërsa shpenzimet udhëtimit duhet të mbulojnë nga vetë kandidatët.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, ju lutemi referojuni materialeve informativë (bashkëlidhur) dhe adresave në web-site:

<http://www.csc.edu.cn/studyinchina>

www.campuschina.org;

http://www.campuschina.org/content/details27_100758.html

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS